

## VIRION GRAÇI

### SHKRIMI ARTISTIK DHE DISKURSI TEORIZUES NË ROMANIN BASHKËKOHOR SHQIPTAR ROMANI SHQIPTAR KUNDËR VETVETES?!

“Shkrimtari nuk i zgjedh temat; ato e zgjedhin atë”<sup>1</sup>

E vendosëm si epigraf thënien e romancierit nobelist Mario Vargas - Llosa për disa arsye: së pari është sintezë e përvojës së një prej shkrimtarëve më të mëdhenj bashkëkohorë; së dyti është e përdorur si argument teorik prej tij në një libër të mirëfilltë studimor për mjeshtërinë e romanit: *Letra një shkrimtari të ri*; së fundi, e kemi përdorur si epigraf pasi, nga pozita vetjake vlerësojmë se romancierët shqiptarë, me përjashtime tepër të pakta, si në periudhën totalitare ashtu dhe aktualisht, iu largohen temave autentike, iu largohen realiteteve dramatike, domethënëse e emocionuese që të ofron jeta shqiptare, kudo.

Në këtë vështrim për romanin shqiptar të dekadave të fundit përveçoj dy përbërës:

1- Trashëgiminë aktive incertike e disa shabllonëve skematikë të realizmit socialist, si para-letërsi, si letërsi, dhe si meta-letërsi; trashëgiminë romanore deri në vitet nëntëdhjetë e çmojmë përcaktuese për shkak se ka të bëjë direkt si me formimin dhe pikënisjet e disa nga romancierët më aktivë të ditëve tona, por edhe me cilësitë e kultivuara ndër vite të ambientit pritës të letërsisë. Sikurse del nga vëzhgimet e librarëve, botuesve, anketuesve, pjesa më e madhe e lexuesve të letërsisë artistike janë të moshës së mesme. Me këtë masë të parapërgatitur lexuesish të rregullt varet jo pak fati i letërsisë, si në rastin kur mirëpritet, ashtu dhe si kategori refuzimi. Kurse përpos letërsisë, kritikës, recensioneve, studimeve, vlen i njëjti arsyetim si për cilësitë e pritësit, të lexuesit.

2- Prirjet e reja anti-roman te disa autorë, romancierë debutues pas viteve nëntëdhjetë. Në atë që quhet Shqipëria shtetërore, zyrtare më shumë, e ca më pak në hapësirat shqiptare në ish Jugosllavi, kemi trashëgiminë aktive, imponuese të realizmit socialist. Pa dashur të humbasim a shpërfillim arritjet

<sup>1</sup> M. Vargas-Llosa, *Letra një shkrimtari të ri*, Onufri, 2008, f. 22.

më të mira të periudhës në fjalë, megjithatë, pajtohemi me faktin se ajo traditë, më e afërta në kohë me romanin dhe zhvillimet më të fundit bashkëkohore, është më determinuesja midis faktorëve objektivë që ndikojnë në proceset letrare-kulturore. Janë formuar në atë periudhë e me ato kanone krijuese pjesa më e madhe e shkrimtarëve të sotëm, pavarësisht moshës, si dhe, lexuesit, në masë përcaktuese.

Njëmendësohemi me prof. Qosjen: “Realizmi socialist, vërtetë, nuk është doktrinë zyrtare në krijimtarinë tonë artistike e shkencore që pesëmbëdhjetë vjet; termat dhe nocionet mbi të cilat mbështetej ai gati janë flakur plotësisht. Por, ndjeshmëria, patosi, retorika dhe gjuha pompoze e tij ende ruhen në shumë shkrime tonat: letrare, shkencore, sidomos publicistike. Në to ruhet ende dhe nocioni *pasqyrim* me të cilin, në thelb përjashtohet ajo vetëdija që quhet vetëdije moderne kritike letrare. As shkrimi folklorik nuk është më shkencërisht i arsyetuar si përpara. Por, ndjeshmëria, pamjet, euforia, gjuha e tij himnizuese kur më pak a më shumë, i zotërojnë mendimet, gjykimet dhe, sidomos, vlerësimet tona, duke u bërë sfragt para Modernitetit në krijimtarinë tonë shpirtërore.”<sup>2</sup>

Një pjesë e madhe krijuesish të periudhës së realizmit socialist, janë ende prodhimtarë, duke ndjekur tashmë një rend krejt të ndryshëm në interpretimin e dukurive, ngjarjeve, proceseve historike etj. Ose dhe duke lëvruar tema tabu që më parë as mund të mendoheshin, pa shtuar këtu kërkimet, “herezitet”, eksperimentet në planet stilistike, kompozicionale. E prandaj e hedhim në diskutim veprimtarinë e tyre të tashme, ballafaquar me botimet e tyre para viteve nëntëdhjetë, si krijimtari e re kundër trashëgimisë së vetë autorit.

Për autorët që kanë filluar të botojnë pas viteve nëntëdhjetë, edhe këtu me pak përjashtime, jemi para një situatë refuzimi të shumëfishtë: refuzohet tradita më e afër e letërsisë shqipe, refuzohet vetë gjinia e romanit si gjini me një minimum karakteristikash bazë të kristalizuara botërisht dhe të afirmuara si produktive dhe autoritare në më tepër se dy shekuj. Autorë debutues më tepër krijojnë realitete tekstologjike të ndërlikuara, sesa gjakojnë të zotërojnë dhe të konvertojnë në ligjërim artistik romanor jetën e gjallë, shoqërinë, individin, epokën. “Kjo letërsi, shkruan prof. Shaban Sinani, karakterizohet nga eklektizmi dhe shthurja”.

Pra, letërsia më e re shqipe, ashtu si dhe ajo e traditës më të afërt në kohë, nguron të matet, në gjithë dimensionet e kësaj fjale, me problematika, dukuri, ngjarje, fenomene kapitale të shoqërisë shqiptare, të bashkëkohësisë. Ndjekës i rregullt i botimeve më të reja nga romani shqiptar, nuk më rezulton e mishëruar në shprehje artistike asnjë nga etapat e të së kaluarës: as periudha

<sup>2</sup> R. Qosja, *Tri mënyra të shkrimit shqip*, Botimet Toena, 2005, f. 7-8.

e shumëpërfolur e diktaturës; as ngjarje të tranzicionit shqiptar; asnjë grup a shtresëzim shoqëror, asnjë grup moshor, rinia, adoleshenca, veteranët, të përndjekurit etj., etj., nuk i gjen të konvertuar artistikisht në asnjë veper romanore deri më sot. Për çfarë flet pra romani më i ri shqiptar? Pa bërë edhe më tej përgjithësime krejt përjashtuese, i japim të drejtë filozofit dhe kulturologut frëng Lyk Ferry kur shkruan:

“Me ekspozitat e tyre pa tablo apo koncertet e heshtjes, avangardat në mbarim e sipër i bënë qesharake format tradicionale të artit dhe shpallën, pa e kuptuar as vetë, eklektizmin “postmodern”: pa mundur të trondisin a të bëjnë ndonjë përmbysje, veprat erdhën e shprehën më shumë vizionin e botës së krijuesit të tyre sesa botën vetë. Akozmizmi (pagjithësia) i estetikës bashkëkohore i sjell një vërtetim të veçantë tezës niçeane sipas së cilës e vërteta e artit qëndron në subjektivizmin e artistit. Zgjatim i thjeshtë i personalitetit të autorëve të tyre, “prodhimet kulturore” priren të bëhen kartëvizita të përpunuara – duke qenë lidhja me realitetin objektiv, qysh atëherë, monopol i shkencave pozitive”<sup>3</sup>.

Për prurjet më të fundit të romanit shqiptar ka mungesa thuajse absolute si të statistikave për ecurinë e tyre në marrëdhëniet me lexuesin ashtu dhe të studimeve dhe vëzhgimeve profesionale për të. Nga të paktët aktivitete për romanin shqiptar është një takim kombëtar në Shkodër, në 2003. Materialet e atij takimi nuk figurojnë të pasqyruara diku. Me interes është një anketë e bërë nga revista kulturologjike *Mehr Licht* në numrin e saj të dytë, janar 1997. Aty shprehen disa nga emrat e afirmuar të letërsisë dhe të kritikës sonë e, krahas tyre, romancierë dhe kritikë të rinj.

Zija Çela:

*Kriza është fati i mirë i romanit...Hataja ndodhi se kjo shkollë ideologjike (soc-realizmi-sh. V.G.) u zgjat dhe u shtri pesëdhjetë vjetë, gati gati sa gjysma e historikut të romanit shqiptar.... As tradita nuk qe aq e fortë sa presioni i saj të ndikonte dukshëm, as brezat e romancierëve aq kryengritës sa të shpëtonin shpirtin e romanit nga parametrat ideologjikë u shpall stabiliteti i romanit, sukcesi i tij qe në të vërtetë atrofizimi i tij...Kështu në historikun e romanit tonë u krijua një boshllëk tjetër, një gavernë e thellë që fundosi shumë shkrimtarë ...Unë kam frikë se romani ynë ka vuajtur nga mungesa e krizës<sup>4</sup>...*

<sup>3</sup> L. Ferry, *Homo Aestheticus*, Botimet “Elena Gjika”, Tiranë, 2002, nga pasthënia autoriale në kopertinë.

<sup>4</sup> “Mehr Licht”, n. 2, janar 1997.

Mehmet Kraja:

*...romani shqiptar nuk mund të jetë tjetër përveç atij që ishte pesë ose dhjetë vjet më parë, pavarësisht se në planin shoqëror kanë ndodhur ndryshime të ndjeshme. Romani shqiptar është në krizë për shkak se janë të pakta fizionomitë e formuara...romancierët tanë kanë bërë zvendësime mekanike, transplantime të gjithfarshme në subjekte, në personazhe herë duke konfirmuar e herë duke përmbysur të dikurshmen...Dikur mjeshtra të një shkollë tash dalin nxënës të dobët ose të tillë që duhet ta mësojnë zanatin nga fillimi. Romani shqiptar është në krizë edhe për shkak të mungesave që ka gjuha e prozës.....ajo është gjuhë e jashtësisë.....nuk prek esencën e gjërave, është ende gjuhë e "kooperativizuar"<sup>5</sup>...*

Teodor Keko:

*edhe në jetën e romanit shqiptar sot ka një krizë.... Kjo është më shumë një krizë identiteti.... Unë mendoj se romancierët e sotëm janë ende larg një njohjeje të pranueshme të realitetit aktual shqiptar, kjo i bën aspak interesantë për lexuesit, domethënë tani kemi një krijimtari romanore pa lexues<sup>6</sup>.*

Ridvan Dibra:

*Normalisht kriza vjen pas kulmesh të arritura. Unë nuk besoj se ka arritur kulme të tilla romani shqiptar... Përpyetje mjaft interesante po bëhen.... Në krizë janë baballarët e romanit me ledhet e tyre anakronike dhe jo romani shqiptar.<sup>7</sup>*

Virion Graçi:

*Romani që shkruhet sot në shqip është kryesisht vijimësi metodike e romanit real-socialist. Zëvendësimet dekorative nuk sjellin dot risi në gjininë sunduese të shekullit.<sup>8</sup>*

Bashkim Kuçuku:

*Është e vështirë që romani shqiptar të jetë në krizë në këto momente, edhe pse vazhdojnë të shkruajnë disa autorë që i kanë dhënë atij fytyrën e vërtetë, veprat e reja të të cilëve pas shqipes, botohen shpejt në gjuhët e mëdha të letërsisë, duke u kthyer në vepra të përbotshme.<sup>9</sup>*

Ramadan Musliu:

<sup>5</sup> "Mehr Licht", n. 2, janar 1997.

<sup>6</sup> "Mehr Licht", n. 2, janar 1997.

<sup>7</sup> "Mehr Licht", n. 2, janar 1997.

<sup>8</sup> "Mehr Licht", n. 2, janar 1997.

<sup>9</sup> "Mehr Licht", n. 2, janar 1997.

*Shqiptarët ende jetojnë në rrethana ku mbizotëron kriza e rrëfimit. Për pesë dekada shqiptarët patën në dispozicion shabllonin e gatsëm narrativ të realizmit socialist. Proza shqiptare nuk e ka sensin e subjektivitetit dhe prirjen për ta identifikuar subjektin brenda një rrethi shoqëror. Me heqjen e realizmit socialist krijuesit shqiptarë kanë mbetur pa modelin narrativ: as dinë çka të rrëfejnë, as dinë si të rrëfejnë. Prandaj kriza e romanit nuk është asgjë tjetër pos një insert nga kriza e përgjithshme në të cilën gjendet një kulturë. Romani shqiptar duhet ta krijojë të ardhmen nëse ky është një lloj ngushëllimi.*<sup>10</sup>

Fatos Kongoli:

*Vlerat e mirëfillta romaneske numërohen me gishtat e dorës. Pa harruar se vitet e fundit ka autorë që nuk po arrijnë ta gjejnë vetveten. Nëse flasim për krizë, ky ndoshta është aspekti më i dukshëm i saj. Autorë që deri dje kanë qenë mjaft prolifikë në krijimin e një letërsie normative duket sikur tani kanë shterur ose kanë shkruar romane shumë të dobët.*<sup>11</sup>

Pranohet nga të gjithë se romani i sotëm shqiptar është në një moment të veçantë, në një moment kthese dhe transformimi rrënjësor. Kritikët dhe shkrimtarët e shprehur në anketë pranojnë faktin se romani shqiptar nuk është më si më parë, baza e tij sociale dhe estetike ka ndryshuar rrënjësisht. R. Musliu shprehet se romanit shqiptar iu hoq modeli narrativ; F. Kongoli shprehet se romancierët më prodhimtarë dhe më të autoritetshëm të periudhës moniste kanë shterur ose botojnë romane shumë të dobët; Z. Çela thotë se romani i tanishëm vjen pas një kaverne gjysmë shekullore që ka gëlltitur shumë shkrimtarë. Sidoqoftë harku kohor për të cilin flitet është me të vërtetë i pamjaftueshëm.

Studiuesi Arben Prendi:

“Një pjesë e shkrimtarëve të realizmit socialist, duke dashur të shugurohen shumë shpejt si shkrimtarë bashkëkohorë e me koncepte moderne për letërsinë, për të ikur nga kiçi socrealist kanë dalë në librari ende me zorrë nëpër këmbë nga lindjet e sforcuara “moderne” të personazheve dhe të situatave në tregimet apo në romanet e tyre tashmë të ngjyrimin ekzistencialist duke shkuar kështu nga kiçi i dogmës te kiçi konsumist. Qartazi po shihet se shkrimtarët e realizmit socialist, përjashtojë ndonjë rast, kanë mbetur momentalisht si lepuri para llampës elektrike, të qorollepsur me ca skema të ndryshkura në tru.”<sup>12</sup>

Duket se qëndron vërejtja e Prendit: “Maksima, me të cilën bashkohen një pjesë e mirë e prozatorëve socrealistë dhe e prozatorëve të rinj dhe një

<sup>10</sup> “Mehr Licht”, n. 2, janar 1997.

<sup>11</sup> “Mehr Licht”, n. 2, janar 1997.

<sup>12</sup> A. Prendi, *Dukuri të reja në letërsinë e viteve të fundit*, në: “Letërsia si e tillë”, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Teona, 1996, f. 414.

pjesë e prozatorëve të rinj, është “antipërmbajtja”, kërcënim i manifestuar si koncept modern që lidhet sidomos me papërcaktueshmërinë e zhanrit, me delirin e krijesit, etj.”<sup>13</sup>

Shumica e të anketuarve e lidhin mungesën e optimizmit për të sotmen dhe të nesërmen e romanit shqiptar me mungesën e një tradite të shquar e të shumëllojtë. Kujtojmë se marrëdhëniet e një shkrimtari me veprën e tij janë të shumëllojta, trashëgimia luan rol, por nuk është as e vetme as e mjaftueshme në formimin e një krijesi. Biografia e vërtetë e shkrimtarit, pasurimi i tij i brendshëm, formimi shpirtëror e mendor kalojnë në mjaft etapa dhe faktorë që nuk janë domosdoshmërisht të lidhur vetëm me vendin ku jeton ose punon ai. Te portreti profesional i artistëve dhe shkrimtarëve lihet në harresë ana e ndikimeve të tij, e cila është shpesh dimension i domethënës, më kuptimplot dhe më shpjegues për një sërë aspektesh të krijimtarisë. Kur janë përmendur ndikimet, janë përmendur në fushata mohimi ose denigrimi të dikujt, por jo si një faktor i fuqishëm pozitiv në mbarëvajtjen e letërsisë. Dihet se periudhat më të mëdha në zhvillimet kulturore të çdo vendi kanë qenë periudhat e ndikimeve; është fjala për ndikime nga periudha të ndritura të historisë njerëzore. Shembujt vërtetojnë se asnjë letërsi e madhe nuk është zhvilluar në kushte izolimi, përkundrazi... Edhe te ne, në kushtet e një izolimi vetëvrasës, një pjesë e mirë shkrimtarësh ishin në kontakte intensive me kulturën botërore, pavarësisht se sa lejoheshin ta reflektonin atë. Kanë studiuar jashtë Shqipërisë rilindasit, shkrimtarët e periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Kanë studiuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë: I. Kadareja, D. Agolli, K. Trebeshina. Kanë lexuar letërsi botërore në disa gjuhë perëndimore P. Marko, F. Ballanca, N. Lera, F. Kongoli etj.. Këtë fat pra, gërshetimin e kulturës shqiptare me qytetërimin bashkëkohor e ka secili prej shkrimtarëve të rinj shqiptarë sot. Arsyet, shkaqet si për sukses edhe për dështim, kanë pushuar së qeni kolektive, përdërisa kanë pushuar së diktuari normat krijuese shtetërore, përdërisa për fatin e librit vendos lexuesi i lirë dhe jo censura zyrtare. Kjo klimë e re e lirisë dhe e mundësive të pakufizuara i heq romancierit tonë çdo pengesë dhe hije inferioriteti paragjykes.

Me përjashtim të R. Dibrës, të tjerët e kërkojnë dhe e presin hapjen e faqes së re në romanin shqiptar nga autorët e dalluar në monizëm. Kraja dhe Musliu zbulojnë qëndrimet e tyre skeptike deri në ironi duke kërkuar nga shkrimtarët e realizmit socialist atë që ata nuk mund ta realizojnë dot: të qenurit individualitete të fuqishëm. Nga shkrimtarët e afirmuar në periudhën e realizmit socialist, të anketuarit e tjerë presin vepra përfaqësuese, por edhe në këtë rast krijohet një ngatërrësë midis një individualiteti dhe mediokritetit. Në këtë mes radhën e gjykimeve e ngatërron vepra e Kadaresë, e cila, jo rrallë, përdoret për të përligjur një metodë krijuese antivlerë. Rigjenerimin e sjell

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 414-415.

shqetësimi për të ardhmen e romanit dhe jo kujdesi i panevojshëm për të shkuarën e tij. Sa më e ndritur të ketë qenë e kaluara e një metode krijuese ose e një shkrimtari aq më pak ai ose ajo ka nevojë për t'u marrë në mbrojtje ose për t'u propozuar si model.

- Rrethanat social-kulturore.

Për rrethanat social-kulturore zgjedhim një përshkrim sintetik të Arben Hoxhës, çfarë i përgjigjet problematikës së përbashkët të këtij tubimi shkencor, qëllimësisë së letërsisë shqipe. Lexojmë:

“Ashtu si në Shqipërinë londineze, ashtu dhe në Jugosllavinë avnojiane të pas luftës së dytë botërore, qasja mbizotëruese për zhvillimin e kulturës do të jetë qasja e karakterit partiak-shtetëror dhe administrativ. Mbizotërimi i modelit të ideologjisë totalitare do të bëhet forca përcaktuese për mbizotërimin e modelit të ideologjisë klasore me qendër-bërthamë ish-Bashkimin Sovjetik e cila do të bëhet përcaktuesja dhe orientuesja e zhvillimeve kulturore-letrare në Shqipërinë londineze deri në fillimvitet '90.”<sup>14</sup>

*Autorë të rinj në kërkim të romanit: A. Tufa, R. Dibra, R. Çollaku, G. Krasniqi.*

Pas vitit 1990 filluan të dalin të skenën letrare autorë të rinj, të njohur pak në periudhën e mëparshme si dhe të rinj debutues, por me krijimtari të bollshme e premtuese si A. Kyçyku, A. Tufa, B. Cufaj, F. Aça, R. Çollaku B. Blushi, G. Krasniqi, R. Erebara etj.

Agron Tufa.

Tematizimi i disa tabuve, si për shembull: seksualja, përzierja e gjinive, cikli poetik midis kapitujve të romanit i bëjnë veprat e A. Tufës mjaft interesante. Krahas heroit problematik i zakonshëm në romanet e traditës, te Tufa shfaqet ndjeshëm edhe autori problematik, sikurse ka paralajmëruar A. Moravia kur ka shkruar në vitet pesëdhjetë për zhvillimet e romanit evropian. Te Tufa autori nuk është problematik për shkak të paafësisë ose papjekurisë profesionale-përkundrazi është një problematikë e nënkuptuar, e ardhur si pasojë e kërkimeve dhe larmisë së formave shprehëse të cilat rezultojnë të suksesshme duke përfundimisht një shumësi kuptimore të tekstit. Tufa synon të pasqyrojë një psikologji komplekse të personazhit, e cila është formuar në disa shtresëzime të ndryshme kohore, me specifika të theksuara dhe synon të zbulohet e të shfaqet njëherësh, përmes një rrëfimi kompleks.

Ridvan Dibra.

<sup>14</sup> A. Hoxha, *Letërsia si vizion*, Instituti albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 51.

Romani *e-m@il* është në skaj të braktisjes së kodeve tradicionale rrëfimtare. Mungesën e intrigës dhe të fabulës së mirëfilltë ai nuk e zëvendëson me organizime të ndërlikuara të lëndës; përkundrazi, edhe forma paraqitet po aq e thjeshtëzuar; një epistolar elektronik, fryt i një imagjinate të mbyllur në vetvete, në qerthullin e monologëve.

Gazmend Krasniqi me rrëfimet në prozë “Eldorado”, Botimet Buzuku, 2008 dhe “Asgjëtë e vogla të zotit”, “OMSCA-1”, 2011, të quajtura prej tij romane, është po ashtu afër antiromanit, ose, do të quheshin më mirë sipas arteve pamore-plastike, instalacione në prozë. Ka në këto romane fragmente teorike, origjinale ose të huazuara, aksioma, interpretime të shpenguara për artin letrar, fjalor termash të studimeve letrare të përfshira në fund të romanit “Eldorado” si pjesë organike e tij, e të tjerë elemente përmbajtësore që e bëjnë veprën romanore dosier, pak ose aspak të ngjashme me ato vepra që jemi mësuar t’i quajmë romane, që i përjetojmë dhe analizojmë zakonisht si të tilla.

Si përfundim mund të shtonim se romani shqiptar sot, me gjithë vështirësitë e përmendura, vazhdon të shkruhet e të botohet pa e shkëputur rrjedhën e vijimësisë, përkundrazi, duke shënuar dukuri dhe autorë interesantë, prurje të larmishme; jo vetëm që nuk është në periudhë shterpësie a steriliteti, sikurse është gjykuar sipërfaqësisht në publik nga njerëz pa informacionin dhe përgatitjen e duhur profesionale, por vazhdon të përsoset nëpërmjet individualiteteve të spikatura, duke e pasuruar e çuar më tej traditën.

## BIBLIOGRAFI

- Akte të Konferencës: “Letërsia si e tillë”, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 28-29 mars 1996.
- Ferri, L., *Homo Aestheticus; shpikja e shijes në epokën e demokracisë*. Botimet “Elena Gjika”, Tiranë, 2002.
- Periodikë letrarë si “Mehr Licht”, “Aleph”, etj.
- Qosja, R., *Tri mënyra të shkrimit shqip*, Botimet Toena, 2005.
- Sinani, Sh., *Letërsia shqipe e shek. XX*, Botimet “Naimi”, Tiranë, 2010.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë: “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqipe”; aktet e seminarit shkencor, Arbëria, 2003.
- Vargas-Llosa, M., *Letra një shkrimtari të ri*, Onufri, 2008.

## SUMMARY

### **LITERARY WRITINGS AND THEORETICAL DISCOURSE: THE ALBANIAN NOVEL AGAINST ITSELF**

This paper aims to draw attention to some protagonists polemics displayed in the Albanian cultural-literary press after restoring freedom of thought and expression. In a selective way, we will recall some of the prominent cases of controversy about literary-cultural issues, not to approach the model that they bring, but to maintain critical, distant attitudes to the benefit of a morality and acceptable intellectual methodology. It is generally noticed that the nihilistic modes of cultural writing like these in the cultural-literary periodicals such as “Word”, “Ars”, “Milosao” are not found in the Albanian cultural press of tradition in the first half of the 20th century. The analyses of this cultural-literary discourse based on the most controversial issues proves the similarity with the discourse paradigms of the first half of the 20th century in Albania, the same accusation strategy not based on facts and language models dominating the world of art and letters during this period with a few exceptions only.

It is concluded that lack of specialised periodicals for poets, novelists, singers, composers, playwrights, and literary critics was the main cause why lack of values dominated the public discourse on culture and literature.

